



Datë: 12.12.2025
Numër Protokolli: 7910/2025

A.nr.1954/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës—Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Merlinda Ramaj, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.1954/2025, të datës 27.11.2025, të parashtruar nga ankuesi K.T, të cilin me autorizim e përfaqëson Avokate Myrvete Hashani Jashari nga Prishtina, kundër organit të punësimit: Komunës së Prishtinës, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.2 dhe 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 12.12.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.1954/2025, e datës 27.11.2025 e parashtruar nga ankuesi K.T, ashtu që, *detyrohet* Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore e Komunës së Prishtinës, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të bëjë shqyrtimin e kërkesës së ankuesit të datës 01.10.2025 dhe të nxjerr aktin administrativ në pajtim me legjislacionin në fuqi.

II. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil, K.T (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi), me datë 27.11.2025, përmes përfaqësuesit të autorizuar, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Komunës së Prishtinës/Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, për mos zbatimin e Akt Emërimit Nr.01-112-1257, të datës 19.11.2024, dhe mos kthimin e përgjigjes ndaj kërkesës me nr. 14-117/01-149756/25, të datës 01.10.2025.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (tutje referuar Kolegji i Këshillit) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 03.12.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Prishtinës, ndërsa, kjo e fundit, më datë 08.12.2025 ka dërguar përgjigjen në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritorë administroi këto prova: Ankesën me numër te protokollit 7599/2025 të datës 27.11.2025 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimin për përfaqësim; Kopjen e ID-së së ankuesit; Akt Emërimit me Nr.01-112-1257 të datës 19.11.2024; Dëshmi e pagave dhjetor 2024; Dëshmi e pagave shkurt 2025; Përgjigje në ankesë e datës 08.12.2025; Kërkesën drejtuar institucionit me numër 14-117/01-149756/25 të datës 01.10.2025; Kërkesën drejtuar institucionit me numër 14-117/01-41750/25 të datës 25.03.2025; Akt Emërimit me Nr.01-113-1237 të datës 19.09.2023; Dëshmi e pagave 01.11.2024-31.12.2025.

Nga administrimi i shkresave të lëndës rrjedhë se ankuesi është i punësuar në Komunën e Prishtinës dhe së e njëjti sipas Akt Emërimit me Nr.01-112-1257 të datës 19.11.2024, mbanë pozitën *Zyrtar për arkiv*, në Drejtorinë e Urbanizmit, ndërsa, organi i punësimit sipas nenit 102, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyratë Publike, ka lëshuar për ankuesin Aktin e Emërimit me Nr.01-112-1257, të datës 19.11.2024, për pozitën e *Zyrtar për arkiv*, klasë profesional 2, klasë të pagës GJ33 dhe koeficient të pagës 5.1.

Ankuesi më datë 01.10.2025 i është drejtuar Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Prishtinës, me kërkesë për realizimin e pagës sipas koeficientit të pagës 5.1-GJ33, duke iu referuar Aktit të Emërimit të lëshuar datë 19.11.2024, ndërsa, sipas shkresave të lëndës dhe pretendimeve në ankesë organi i punësimit nuk ka dhënë përgjigje në kërkesën e ankuesit të datës 01.10.2025.

Kundër heshtjes administrative të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, ankuesi ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor se i njëjti është duke u dëmtuar financiarisht, pasi që pavarësisht faktit se organi i punësimit ia ka lëshuar Aktin e Emërimit me koeficient 5.1, i njëjti nuk është duke u kompensuar sipas koeficientit të ri. Kërkon të aprovohet ankesa, të obligohet Komuna e Prishtinës të zbatoj akt emërimit e datës 19.11.2024, dhe ti bëj kompensimin sipas koeficientit 5.6 nga dita e nënshkrimit të akt emërimit deri në nxjerrjen vendimit.

Kolegji i Këshillit ndërlidhur me rregullat e veprimeve procedurale të një organi publik, ju referua dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (tutje referuar: LPPA), përkatësisht nenit 10 paragrafi 2 ku përcaktohet se: 2. *Organi publik zhvillon procedurën administrative sa me të shpejtë dhe me sa më pak shpenzime, për të dhe për palën, duke mos cenuar çfarë është e nevojshme për një rezultat të ligjshëm e të përshtatshëm të procedurës administrative*, nenit 98 paragrafi 1 dhe 2 ku përcaktohet se: 1. *Procedura administrative nisur sipas kërkesës, do të përfundojë sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se sa afati i përcaktuar me ligj të veçantë për atë lloj procedure.* 2. *Në rast se ligji i veçantë nuk ka paraparë një afat, siç është paraparë në paragrafin 1 të këtij neni, afati i përgjithshëm i zbatueshëm për përfundimin e procedurës administrative është dyzetepesë (45) ditë nga fillimi i saj, si dhe nenit 97 paragrafi 1 të këtij ligji, ku përcaktohet se: 1. Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon me njoftimin e një akti administrativ apo lidhjen e një kontrate administrative, dhe si rrjedhojë në kuptim të këtyre dispozitave ligjore si dhe bazuar në shqyrtimin e provave materiale të çështjes, dhe si rrjedhojë në kuptim të këtyre dispozitave ligjore si dhe bazuar në shqyrtimin e provave materiale të çështjes, Kolegji i Këshillit konstatoi se organi përkatës i punësimit, në rrethanat e rastit konkret, nuk ka vepruar në pajtueshmëri me dispozitat përkatëse ligjore, në raport me Kërkesën e datës 01.10.2025 të parashtruar nga ankuesi, ngase sipas bazës ligjore si me sipër, vullneti i organit publik në realizimin e autoritetit publik formësohet në procedurë administrative dhe manifestohet në formën e njërit prej veprimeve administrative, siç janë: akti administrativ; kontrata administrative apo akti real, dhe se në vlerësimin e Kolegjit, organi përkatës i punësimit, në kuadër të autorizimeve të përcaktuara me legjislacionin në fuqi, është dashur që të nxjerr akt administrativ në*

kuptim të vendosjes dhe të njoftoj palën për aktin e tillë, brenda një afati prej 45 ditësh sikurse përcaktohet me nenin 98 paragrafi 2 apo afatit të vazhduar sipas nenit 99 paragrafi 1 të LPPA-së.

Kështu që, thënë si më sipër e duke u bazuar në nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi të aprovoj si të bazuar në kuptim të shkeljeve procedurale, dhe si rrjedhojë detyroj Njësinë e Burimeve Njerëzore të Komunës së Prishtinës, që në respektim të dispozitave procedurale të shqyrtoj kërkesën e ankuesit të datës 01.10.2025 dhe të nxjerr akt administrativ në përputhshmëri me dispozitat ligjore në fuqi.

Këshillë juridike: Ky vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda: A.nr.1954/2025

Merlinda RAMAJ

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Përfaqësueses së ankuesit Avokates znj. Myrvete Hashani-Jashari;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore të Komunës së Prishtinës;
- Arkivit të KPMSHCK-së;